

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kush është Behajdin Allaqi, njeriu që Haga vendosi në qendër të dënimit të Thaçit dhe pikëpyetjet për zhdukjen e tij
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/17/kush-eshte-behajdin-allaqi-njeriu-qe-haga-vendosi-ne-qender-te-denimit-te-thacit-dhe-pikepyetjet-per-zhdukjen-e-tij/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 06:49:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	16 shtator 2026, 22:00:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 16 shtator 2026, 21:59:00 UTC → 16 shtator 2026, 22:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fba83cd841921cf52f7b64262834860fbb73b8f1d202b81fcd56ad2882d788e5
TEKSTI	ef7875e8e8db745b24bba11ec7fac2c3fa9722a03fad559bbe2d76a7e4f52a2b
PAMJA	2356ac33fda5eae1c2650d1f1f7f4cc3076a0c37ceb187fab2ee7dd72dc4f739

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f20777ea879d2b1d5529c5d26e40621bb5c43f818e328eff7c7d2c53b951858c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3cbdf23231ddbe1301737130b50cb215bb8d138f7bee92a7c7c6c6c8c9c45afe
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f20777ea879d2b1d5529c5d26e40621bb5c43f818e328eff7c7d2c53b951858c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kush është Behajdin Allaqi, njeriu që Haga vendosi në qendër të dënimit të Thaçit dhe pikëpyetjet për zhdukjen e tij

Kryesore

Publikuar: 17/09/2026



Emri i Behajdin Allaqit është rikthyer papritur në qendër të vëmendjes pas aktgjykimit të Dhomave të Specializuara ndaj Hashim Thaçit dhe tre ish-drejtimesve të tjerë të UÇK-së.

Allaqi nuk është thjesht një nga emrat e shumë të përmendur në dosjen voluminoze të Hagës. Në rastin e tij, Trupi Gjykues shkoi shumë më tej, duke arritur në përfundimin se Thaçi kishte marrë pjesë personalisht në arrestimin, ndalimin, transferimin dhe vrasjen e tij. Ky është një nga konstatimet më të drejtpërdrejta të aktgjykimit ndaj ish-presidentit të Kosovës.

Por kush ishte Behajdin Allaqi dhe pse historia e tij, e nisur shumë përpara luftës së Kosovës, përfundoi duke u bërë një prej pikave kyçe të çështjes kundër Thaçit?

Behajdin Myrteza Allaqi lindi më 7 prill 1963 në Prizren. Ai kishte studiuar filozofi dhe punonte si profesor i lëndëve sociologjike në gjimnazin e Prizrenit. Burimet biografike për të e përshkruajnë si veprimtar politik që prej viteve '80 dhe si pjesëmarrës në demonstratat e vitit 1981. Më vonë u përfshi në Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës dhe në aktivitetet politike ilegale kundër pushtetit jugosllav.

Ai kishte pasur edhe probleme me autoritetet serbe. Burimet biografike dhe dokumentet e publikuara për të tregojnë se ishte dënuar nga Gjykata e Qarkut në Prizren në vitin 1993 dhe, pas lirimit, ishte rikthyer në punën e tij si profesor.

Me te lexuarat

Kush është

**Behajdin Allaqi,
njeriu që Haga
vendosi në
qendër të
dënimit të
Doktor Mziu**



te Ruga e
Kosovarëve
dhe biznes
shit-blerje
pronash,
deri pas dash-
nës video



**pornografike
në një bisedë
me shoqet, si u
zbulua abuzimi
i 12-vjecares**



Historia e
gjeneralit kroat
të Bosnjes që
vrau veten me
helm në sallën
e gjykimt në
Lugje rano dhe
Miroslav



me naftë/
Shehu kërkon
llogari për
gjenocidin
serb, Haga
rikthen akuzat
e ...



Me krijimin e celulave të para të UÇK-së në zonën e Prizrenit, Allaqi u përfshi edhe në organizimin e tyre. Sipas biografive të publikuara ndër vite, ai mori pjesë në organizimin e aktiviteteve në zonën e Përdrinisë dhe në ngritjen e rrjetit për transportimin e armatimit përmes Pashtrikut.

Pikërisht këtu historia e tij ndërthuret me atë të Hashim Thaçit.

Sipas konstatimeve të Trupit Gjykues, përplasja mes tyre kishte nisur vite përpara zhdukjes së Allaqit.

Gjykata thotë se në vitin 1993 Allaqi pati një mosmarrëveshje serioze me Hashim Thaçin dhe Azem Sylën. Sipas versionit të pranuar nga Trupi Gjykues, ata e akuzonin Allaqin se kishte futur në lëvizjen politike ku bënë pjesë një person të dyshuar prej tyre si spiun të Serbisë, Shaban Shalën, duke vënë në rrezik anëtarët e organizatës.

Aktgjykimi thotë gjithashtu se si pasojë e kësaj përplasjeje, Thaçi mori një rol që më parë i ishte premtuar Allaqit.

Kjo histori e vitit 1993 është e rëndësishme sepse Trupi Gjykues e përdor atë si pjesë të sfondit të asaj që, sipas tij, ndodhi pesë vjet më vonë.

Në qershor 1998, Allaqi ishte ende aktiv. Më 11 qershor, sipas burimeve biografike, ai shkoi në shtabin e UÇK-së në Drenoc. Që nga ajo ditë familja e tij nuk mori më informacion të sigurt për fatin e tij dhe vendndodhja e trupit të Allaqit mbeti e panjohur.

Por Haga tani ka dhënë një rindërtim shumë më konkret të asaj dite.

Sipas Trupit Gjykues, përpara zhdukjes së tij Allaqi ishte vendosur nën vëzhgimin e shërbimit të zbulimit të UÇK-së dhe Thaçi e Kadri Veseli kishin kërkuar të informoheshin për praninë e tij në shtabin e Drenocit.

Gjykata konstatoi se më 11 qershor 1998 Allaqi shkoi në shtabin e UÇK-së në Drenoc dhe se pak më vonë atje mbërritën Thaçi dhe Veseli. Sipas përfundimit të gjyqtarëve, ata e morën Allaqin në pranga. Ai nuk u pa më dhe Trupi Gjykues arriti në përfundimin se ishte vlarë.

Rasti bëhet edhe më i rëndë në një tjetër pjesë të aktgjykimit.

Gjykata thotë se më 1 nëntor 1998 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së publikoi Komunikatën nr. 61, sipas së cilës Allaqi kishte rënë dëshmor në betejë. Trupi Gjykues e interpretoi këtë komunikatë si një përpjekje për të fshehur atë që, sipas tij, kishte ndodhur realisht me Allaqin.

Përfundimet e Gjykatës shkojnë edhe pas përfundimit të luftës. Në përmbledhjen e aktgjykimit u tha se Thaçi, Veseli dhe Azem

zyta u perpoqen me pas ta binimin familjen e Allaqit, permes premtimeve dhe ryshfetit, të hiqte dorë nga kërkimi i së vërtetës dhe drejtësisë. Ky është konstatim i Trupit Gjykses dhe jo një fakt i pranuar nga mbrojtja.

Kjo është arsyeja pse emri i Behajdin Allaqit merr një peshë të veçantë në aktgjykimin ndaj Thaçit.

Në shumë pjesë të çështjes përgjegjësia e ish-drejtuesve të UÇK-së është analizuar përmes koncepteve të përgjegjësisë penale dhe kontributit në një qëllim të përbashkët. Te Allaqi, përfundimi i Gjykatës është individual dhe shumë më konkret: Dhomat e Specializuara deklaruan zyrtarisht se Thaçi mori pjesë personalisht në arrestimin, ndalimin, transferimin dhe vrasjen e tij.

Pikërisht këtë pjesë po godet tani fort mbrojtja e Thaçit.

Avokati Luka Misetic pretendon se Gjykata bëri publik përfundimin për përfshirjen e Thaçit në vrasjen e Allaqit, ndërkohë që më parë kishte urdhëruar që palët të mos e diskutonin rastin publikisht dhe që provat përkatëse të mbaheshin konfidenciale.

“Mbrojtja argumenton se gjetjet e Trupit Gjykses për fajësinë përtej dyshimit të arsyeshëm mbështeten në prova të pamjaftueshme dhe të pakonfirmuara. Për më tepër, Trupi Gjykses dje deklaroi publikisht se z. Thaçi ishte i përfshirë në vrasjen e Behajdin Allaqit, pasi kishte urdhëruar të gjitha palët në këtë çështje që të mos e diskutonin rastin e z. Allaqi në seancë publike dhe pasi kishte urdhëruar që të gjitha provat lidhur me këtë rast të mbaheshin konfidenciale”, deklaroi Misetic.

Sipas tij, kjo ka krijuar një situatë paradoksale: përfundimi kundër Thaçit është bërë publik, ndërsa një pjesë e materialit mbi të cilin ai mbështetet nuk ka qenë e disponueshme për shqyrtim publik.

“Kështu, Trupi Gjykses e ka shpallur publikisht z. Thaçi fajtor për një vrasje, ndërkohë që provat mbi të cilat është bazuar ky përfundim i janë mbajtur të fshehura shqyrtimit publik. Z. Thaçi do ta mirëpriste shqyrtimin publik të këtyre provave”, tha avokati, duke shtuar se Thaçi mohon shprehimisht çdo përfshirje në vrasjen e Allaqit.

Ka edhe një element tjetër që e komplikon historinë.

Një raport hetimor i vitit 2000, i bërë publik këto ditë, përmban një version të atribuar bashkëshortes së Allaqit, Nazmije Allaqi. Sipas dokumentit të publikuar, ajo kishte raportuar se bashkëshorti ishte zhdukur më 11 qershor 1998 dhe se ishte marrë nga policia serbe në Drenoc.

Ky informacion duket në kundërshtim me rindërtimin e ngjarjes që Trupi Gjykses ka pranuar në aktgjykimin e vitit 2026.

që Trupi Gjykses ka pranuar në aktgjykimin e vitit 2020. Megjithatë, vetëm ekzistenca e këtij raportimi të vitit 2000 nuk mjafton për të rrëzuar përfundimin e Gjykatës: për këtë do të duhet të dihet se si është administruar ky material në proces, çfarë provash të tjera ka pasur Trupi Gjykses dhe si i ka vlerësuar ato në aktgjykimin e plotë.

Edhe vetë Thaçi ishte pyetur më herët për Allaqin. Në një transkript zyrtar të procesit, të diskutuar gjatë dëshmisë së Fadil Gecit në tetor 2024, citohet një përgjigje e mëparshme e Thaçit për Prokurorinë, ku ai thoshte se çështja e Allaqit ishte politizuar për “motive” dhe “qëllime politike”.

Kështu, pas gati 28 vjetësh, historia e Behajdin Allaqit mbetet një nga nyjet më të ndërlikuara të çështjes së Hagës.

Nga njëra anë është përfundimi i prerë i Trupit Gjykses të shkallës së parë: Allaqi u arrestua, u transferua dhe u vra dhe Thaçi mori pjesë personalisht në këto krime. Nga ana tjetër është mohimi kategorik i Thaçit dhe pretendimi i mbrojtjes se përfundimi është ngritur mbi prova të pamjaftueshme, një pjesë e të cilave vazhdon të jetë larg syrit të publikut.

Pikërisht për këtë arsye, Behajdin Allaqi nuk është vetëm një emër në aktgjykimin e 16 shtatorit. Rasti i tij pritet të jetë një nga pikat ku mbrojtja e Thaçit do të përpiqet të godasë drejtpërdrejt përfundimet faktike të Trupit Gjykses në apel. /Pamfleti

TAG:

Behajdin allaqi

Hashim thaçi

Të ngjashme



Skandali në tenderin e KQZ: Si ndërhyri Sekretarja në sistem për favorizuar kompaninë e vëllain e Ferit Hoxhës që hetohet në dosjen e AKSHI-t



Çoi padashje një video pornografike në një bisedë me shoqet, si u zbulua abuzimi i 12-vjeçares në Tiranë. Hetuesit u tronditën nga pamjet



Furnizoi Millosheviçin me naftë/ Shehu kërkon llogari për gjenocidin serb, Haga rikthen akuzat e Berishës ndaj UÇK-së

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

KREU INVESTIGIM

KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË

KRYESORE POLITIKË EKONOMI

ANALIZË RAJON KULTURË SPORT

informimin e opinionit publik në mënyrë të
paanshme, profesionale dhe në dritën e të
vërtetës, mbi çështje që lidhen me
korrupsionin politik, krimin,
pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive
publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe
lidhjet e padukshme mes partive politike,
mediave të njësuar me interesat
klienteliste, krimit dhe biznesit jo të
ndershëm, të cilët në bashkëpunim
përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.